



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. _____ prot.

Lezhe, me ____/____/2021

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

28.09.2021

Drejtuar: "POWER INDUSTRIES" SH.P.K, me adrese Zona Kadastrale, Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m2, Vorë, Picar, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar/ Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04839-09-08-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje vegla pune dhe paisje sigurimi teknik"

Kohëzgjatja e kontratës: 5 dite

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "ENDI 94" SH.P.K me Numer NIPT K01423004K

Vlera: 1,250,000 (nje milion e dyqind e pesedhete mije) Lek pa Tvsh.

2. Operatori Ekonomik "POWER INDUSTRIES" SH.P.K me Numer NIPT L51706022H

Vlera: 1,390,000 (nje milion e treqind e nentedhete mije) Lek pa Tvsh.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "ENDI 94" SH.P.K me Numer NIPT K01423004K,

per arsyet e mëposhtme:

Se pari, nuk permbush kriterin 2.3.2 ne te cilin kerkohet se Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO perkatesisht:

- Çertifikatë ISO 9001:2015, mbi "Sistemin e menaxhimit te cilësisë" lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe

verteton se OE të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO 9001:2015, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”.

Se dyti, nuk permbush kriterin 2.3.4 ku parashikohet se operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë aktin e marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, pasi OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtij kriteri.

Se treti, nuk permbush kriterin 2.3.5 ku parashikohet se operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike, pasi OE nuk ka paraqitur asnjë katalog ose fragmente të katalogut të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it sipas kërkesave të DST duke mos përmbushur këto kriter.

Se katërti, nuk permbush kriterin 2.3.6 ku parashikohet se Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor, pasi OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe asnjë oferte teknike.

Se pesti, nuk permbush kriterin 2.3.7 ku parashikohet se ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë nga 1 (një) mostër për secilin nga artikulli të kërkuar në DSt, pasi bazuar në procesverbalin nr 01. datë 27.09.2021 të komisionit të vlerësimit të ofertave, OE nuk ka paraqitur në datën dhe orën e hapjes së ofertave mostrat e kërkuara sipas pikës 2.3.7 të DST-se.

Per sa me siper oferta e dorëzuar nga OE “ENDI 94” SH.P.K, me Nuis K01423004K, *skualifikohet.*
* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “POWER INDUSTRIES” SH.P.K, me adresë Zona Kadastrale, Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m², Vorë, Picar, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,390,000 (një milion e treqind e nëntëdhjetë mijë) Lek pa Tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU